

SHFK “LIRIA” TETOVË

PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E

PSIKOLOGUT

viti shkollor 2023/2024

PLANI PËR PUNË DHE DETYRAT PUNUESE TË PSIKOLOGUT TË SHKOLLËS

Punëtorët profesional ,si edhe subjektet e tjera të cilët janë të kyqur në procesin edukativo-arsimorë,kanë lëmitë e tyre të veprimit.

Puna e psikologut të shkollës është e ndarë në disa segmente, dhe ate:

1. Planifikimi, programimi dhe organizimi i punës edukativo –arsimoree cila i përfshinë këta aktivitete:

2. Përcjellja e punës edukativo-arsimore në shkollë nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- regjistrimin e nxënësve dhe përcjelljen e zhvillimit të tyre në shkollën fillore,
- bashkëpunimin me prindërit,
- përkrahjen e punës së bashkësisë së nxënësve,
- përkrahjen e arsimtarëve për punën individuale me nxënësit,
- I zbulon nxënësit (në bashkëpunim me arsimtarët) me vështirësi në përparim dhe punon me ata ;
- I zbulon nxënësit me mundësi më të mëdhaja për përparim dhe zhvillim,u jep kahje aftësive të tyre;
- Punon në fushën e orientimit profesional të nxënësve
- Për realizimin e këtyre aktiviteteve , psikologu shfrytëzon metoda dhe teknika nga më të ndryshmet me të cilat disponon.
- Zbulon dhe punon me nxënësit që manifestojnë sjellje të pa hijshme,si që është e pa arsyetueshme ose mungesa e shpeshtë dhe numri i ritur e mungesave, paraqitja e dukurisë së të pyerit të duhanit,sjelljes agresive.
- Mban këshillime grupore dhe individuale me prindërit/kujdestarët për nxënësit që kan nota të dobta ,mungesa të paarsyeshme,sjellje të pa përshtatëshme.

3. Puna këshilluese-konsultative

Kjo lloj pune zbatohet në punën me nxënës, prindër dhe, nëse është e nevojshme, me mësues. Këshillimi realizohet me ftesë paraprake të prindit të fëmijës i cili tregon sukses të reduktuar, sjellje të papërshtatshme ose një numër të madh mungesash. Këshillimi kryhet dy herë në një periudhë prej dy javësh ndërmjet dy seancave këshillimore. Në punën me mësuesit, merr formën e bashkëpunimit në lidhje me të gjitha problemet në shkollë, të cilat i referohen përmirësimit të procesit arsimor.

Kurse në punën me arsimtarët, ky ka formë të bashkëpunimit në lidhje me të gjitha problemet në shkollë, dhe që i përket përparimit të procesit edukativo-arsimorë.

4. Përsosje e përgjithshme profesionale e kuadrit edukativo-arsimorë:

- Bashkëpunim me arsimtarët në përgaditjen e të gjithë llojeve të programeve për punë;
- Punon në përparimin e notimit të diturive të nxënësve, posaçërisht me klasët e para dhe të dyta, që janë më tani të kyqura në notimin përshkrues;
- Përfshirja në ekipin gjithëpërfshirës të shkollës

5. Mbajtja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike

- Shiqimi i evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit shkollorë dhe kuadrit arsimorë.
- Mbajtja e vërejtjeve ditore.
- Mbajtja e dosijeve profesionale për të punësuarit e palës maqedone(të tjerët i udhëheq pedagogu i shkollës)
- Procesverbale të bisedave me nxënës, prindër dhe arsimtarë.
- Mbajtja e evidencës dhe dokumentacionit personal
- Ditari kronologjik i punës:
- Procesverbali i konsultimeve të realizuara me prindërit
- Procesverbalet e monitorimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve
- Të dhënat e vizitave në klasa, seminare, trajnime, seminare, klasa të hapura etj.

6. Përgaditja e materijaleve profesionale

- Në mvarshmëri nga nevojat ,nga rezultatet e fituara dhe njohurive, përgaditë materiale të shkruajtura ,të cilat prezentohen para organeve profesionale të shkollës.

Aktivitete zhvillimore

Aktivitete zhvillimore të punës së psikologut janë në funksion të realizimit të detyrave dhe aktiviteteve zhvillimore të shkollës për vitin shkollorë aktual këto janë:

-
- Puna me arsimtarët në planifikimin e notimit, zgjedhje dhe pregaditje të kriteriumeve. Metodave, teknikave dhe instrumenteve për përcjelljen dhe notimin e të ariturave të nxënësve.
- Përcjellja, hulumtimi dhe vlerësimi i zbatimit të risive, shkallës së përmirësimit të kontinuitetit, objektivitetit, drejtësisë dhe dukshmërisë në notimin e të ariturave të nxënësve
- Punëtori me nxënësit me qëllim: Nxitja e sjelljes positive dhe ngritje të motivimit për mësim- nëpërmjet kycjes në procesin e të notuarit.
- Realizimi i seminareve - Kodi i Etikës për vlerësimin e nxënësve dhe mësuesve
- Vështrim mbi cilësinë e përfshirjes së prindërve në procesin e vlerësimit
- Mbështetje në aktivizimin e punës së parlamentit të nxënësve.
- Ngritja e motivimit për të mësuar - përmes përfshirjes në procesin e vlerësimit;
- Puntori, tribuna dhe debate me prindërit.
- Punë këshillimore me të gjithë faktorët në shkollë, në të gjitha nivelet dhe realcionet(mardhëniet).
- Asistencë në zhvillimin e planeve individuale të punës për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore në procesin edukativo arsimorë të rregullt
- Asistencë në zhvillimin e planeve individuale të punës për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore.

1. Planifikimi, programimi dhe organizimi i punës edukative arsimore, i cili i përfshinë aktivitetet që vijnë

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Konsultime dhe pjesëmarrje në pregaditjen e Programës vjetore të punës së shkollës	Pjesëmarrje aktive në planifikimin e tërësishmëm të punës së shkollës	Gusht, Shator	Drejtor Nd,drejtor Psikologu Pedagog	Punë ekipore Individuale	Koncepcioni për shkollën fillore Standardet për shkollën fillore	Efikasitet me I madh në punë> Pregaditja me kohë për fillimin e vitit shkollorë
Orientimi në planifikim dhe punim I programës për punë të këshillit arsimorë, të klasëve dhe të prindërve	Pjesëmarrja në planifikimin e punës së organeve profesionale	Gusht, Shtator	Drejtor Nd,drejtor Psikologu Pedagog	Punë ekipore Individuale	Materiale profesionale,Të dhëna nga ditarët dhe nga dokumentet ekzistuese	Efikasitet në punë e organeve profesionale
Pjesëmarrja në pregaditjen e programës vjetore të aktiveve	Orientimi I punës së aktiveve	Gusht, Shator	Përgjegjësit e aktiveve profesionale	Këshillim Punë ekipore	Përgjegjësit dhe anëtarët e aktivvev profesionale	Përmirësimi I planifikimit dhe efikasitet
Punimi I programës personale për punë	Planifikimi I punës personale	Gusht, Shtatorë	Kolegë nga shkolla	Individuale	Literaturë ptofesionale	Pasqurim më të mirë dhe efikasitet
Përpunimi I programës për orë klasë	Orientimi I punës së kujdestarëve të klasëve	Shtator	Kujdesatrë të klasëve	Punë ekipore Këshillim	Literaturë profesionale Materiale ngaseminari	Theksimi dhe zhvillimi I komponentave educative
Punim të raportit të gjysvjetorit dhe në fund të vitit	Pasqyrë e përgjithshme për numrin, suksesin dhe sjelljen e nxënësve	Janar, Qershor	Drejtor Nd,drejtor Psikologu Pedagog arsimtarë	Individuale Këshillime	Ditarë, programe Të dhëna nga arsimtarët	Pasqyrë e tërësishme në realizimin e planifikimit dhe programimit
Planifikimi I realizimit të aktiviteteve projektuese	Kycja e shkollës në projekte dhe bashkëpunimi me shkolla tjera dhe organizata	Gjatë vitit	Drejtor Koleg,punëtorë profesiona Organizata qeveritare dhe jo qeveritare Shoqata	Këshillim, punë ekipore	Literaturë profesionaleMateriale nga seminarat	Përmirësimi I gjendjes së tërësishme në shkollë, komunikim , pregaditshmëri sukses etj.

2. Përcjellja e punës edukativo arsimore në shkollë nëpërmjet aktiviteteve

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Formimi I paraleleve Për klasë të parë	Shpërndarja e drejtë e nxënësve në paralele	Gusht	Drejtor , ndihmës drejtor. Psikologu pedagog	Punë ekipore Individuale	Shënime nga Regjistrimi, Bisedë me prindët e nxënësve	Ndarje e drejtë e fëmijëve nëpër paralele
Pëercjellje të rrethanave dhe kushteve për organizimin dhe realizimin e mësimi	Shiqim në realizimin E procesit mësimorë në shkollë	Shtator	Drejtor Nd,drejtor Psikologu Pedagog	Përcjellje, Punë ekipore Individuale Vështrim IGjendjes	Orari mësimorë	Zhvillimi pa pengesë I procesit edukativo mësimorë
Kontroll I dokumentacionit pedagogjik	Shiqim I tërësishëm në mënyrë të vazhdueshme në evidencën dhe dokumentacionin	Gjatë viti shkollorë	Pedagog Psikologu Arsimtarë	Përcjellje Konsultim Vështrim I gjendjes Punë ekipore	Ditarët e klasës Programe të punës Plane tematike, mujore dhe vjetore	Rregullësi në mbajtjen e dokumentacionit të tërësishëm
Vizitë orëve mësimore	Përcjellje të punës së arsimtarit dhe nxënësit gjatë orës së mësimi	Gjatë vitit shkollorë	Drejtor Psikolog Pedagogo Arsimtarë Nxënës	Përcjellje Shënim Konsultim	Planifikimi Literatura profesionale	Përmirësimi I rezultateve të nxënësve dhe punës së arsimtarit
Përcjellja e realizimit aktiviteve jashtëmësimore	Shiqim në realizimin e tyre	Gjatë vitit shkollorë	Kujdestarë të klasëve Arsimtarë tjerë	Konsultim Bashkëpunim Bisedë	Programet e punës së kujdestarëve të klasëve dhe arsimtarëve	Rritja e interesit dhe efikasitetit të punës së nxënësve
Vështrim mbi cilësinë e bashkëpunimit me prindërit	Monitorimi i realizimit të punës me prindërit	Gjatë vitit shkollorë	Kujdestar klase Bashkpuntorët profesional	përcjellje anketim raport	Literaturë profesionale programë procesverbalet	Forcimi i bashkëpunimit me prindërit

3. Punë studjuese – analitike

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Pregaditja e instrumeneteve për grumbullimin e të dhënave, përpunimi I të dhënave dhe pregaditja e raportit për suksesin , sjelljen, mungesat dhe të dhëna tjera për nxënësit sipas periudhave kohore në shkollë	Pasqyrimi I gjendjes	Janar Qershor	Shërbimi professional Pedagogu Psikologu	Pasqyra analitike Statistika	Të dhënat nga arsimtarët. Ditarët	Pasqyrim I gjendjes
Analiza e suksesit të nxënësve të cilët kalojnë nga mësimi klasorë në mësimin lëndorë (Kl. IV në kl.V)	Vështrim kritik Përcjellja e kontinuitetit të suksesit	Dhjetorë Maj	Mësuesit e klasëve të IV Kujdestarët e klasëve të V	Ekipore Individuale	Të dhënat nga ditari I pasqyrës së suksesit të nxënësve Bisedë me arsimtarët udhëheqës	Efikasitet në përcjelljen e vazhdueshme të suksesit të nxënësve
Anketimi I nxënësve të klasëve të VII dhe të VIII për probleme aktuale për moshën e tyre	Konstatimi I nevojës për dhënje këshilla	Gjatë viti shkollorë	Shërbimi professional	Anketim Bisedë	Të dhënat nga nxënësit dhe arsimtarët	Efikasitet në konstatimin e nevojave të nxënësve dhe ofrimi ndihmë nxënësve
Pjesëmarrja në Kërkimet të cilat I organizon shërbimi profesional I shkollës apo ndonjë instituciona jashtshkollorë	Për nevojat e shërbimeve	Gjatë viti shkollorë	Shërbimi professional	Anketim Bisedë	Të dhëna nga subjektet të cilët kryen në kërkim	Pasqyrë për gjendjen e problemit të kërkuar
Pregaditja e instrumenteve me kërkesë të arsimtarëve. Për nevoja të ndryshme (teste, pyetësorë,,\ fletëza mësimore etj)	Për nevojat të arsimtarëve	Gjatë viti shkollorë	Shërbimi professional	Testim Anketim Punëtori	Të dhëna nga nxënësit dhe arsimtarët	Konstatimi I gjendjes së problemit që është lëndë kërkimi

4. Puna me organet profesionale

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Pjesëmarje në punën e këshillave të klasëve dhe arsimore	Shiqim në realizimin e aktiviteteve të planifikuara	Gjatë vitit shkollorë	Drejtor Nd, drejtor Psikologu Pedagog	Raporte, Analiza Pjesëmrye në mbledhje	Programa oër punë të aktiveve profesionale	Orientimi për punë më të suksesshme dhe efektive
Orientim në punimin e planeve dhe programeve vjetore Organizimi I garave Ekskurzioneve Punëtorive dhe aktiviteteve tjera	Aktivizimi Ipersonalit arsimorë për punë të pamvarur	Gjatë vitit shkollorë	Arsimtarë, Pedagog	Punë ekipore Këshilime	Programe për punë të aktiveve profesionale	Komunikim më të madh të personelit arsimorë me shërbimin professional në shkollë

5. Bashkëpunim me arsimatrët

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Dhënja ndihmë profesionale arsimtarëve fillestarë	Kycje më e shpejtë dhe më e mirë në procesin mësimorë	Gjastë viti shkollorë (sipas nevojës)	Psikologu Arsimtarët	Këshillim, bisedë	Literaturë profesionle Dokumentacioni ekzistues	Aritja e sigurisë në punë dhe zhvillimi I komunikimit reciprok

Informim për përparimin në mësim në aspekt pedagogjik dhe psikologjik	Qasje më të lehtë të arsimtarëve në procesin arsimorë	Gjatë viti shkollorë	Arsimtarët Psikologu Pedagogu	Punë ekipore, punëtori, Këshillim	Literaturë profesionale Revista Njohuri nga seminarët	Arsimtarët të arrijnë njohuri të reja dhe të jenë në rrjedhë me ndryshimet dhe risitë në shkollëtë arihen
Arsimim për shkathtësitë jetësore	Arsimtarët të aftësohen që ti përcjellin të nxënësit shkathtësitë jetësore, njëherit nxënësit të njejtat ti përvehtësojnë dhe të dijnë njëherit edhe ti shprehin në jetën e përditshme	Shator Tetor	Kujdestarët e klasëve	Punëtori. Punë grupore	Doracakj për shkathtësitë jetësore	Arsimtarët mundën me sukses ti përcjellin dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet për tematg të cilat punohen net re klasët (Klasa e parë, e dytë dhe e tretë)
Bisedë dhe zgjedhje të problemve të caktuara (me nxënës, diciplinë, sukses, sjellje etj	Zgjidhje më e suksesshme E problemve	Gjatë viti shkollorë	Arsimtarë Nxënës	Këshillim Punë individuale Punë ekipore Këshillim Bisedë	Vërejtje,Njohuri Literaturë profesionale	Përmirësimi I klkimes për punë dhe motivim të arsimtarëve për qasje të hapur ndaj problemeve në shkollë
Ndihmë arsimtarëve në hartimin e testeve të diturive pyetësorëve Zbatimin e standardeve në notim e të tjera	Të përmirësohet cilësia e notimit dhe përcjelljes së drejtë të përparimit të nxënësve, të arrijnë më shumë njohuri të reja për notimin	Gjatë viti shkollorë	Arsimtarët	Këshillim Prezentim Udhëzim	Vërejtje Njohuri Literaturë profesionale Materiale nga seminarët	shfrytëzimi I më shumë diturive dhe instrumenteve për notim më objektiv
Përparimi I punës ekipore	Të gjindemi në rrjedhë me mësimin bashkëkohorë	Gjatë vitit shkollorë	Arsimtarët	Punëtori Trajnim	Literaturë profesionale Materiale nga seminari	Të shihet përparësia e punës ekipore dhe zbatimit të njejtës

6. Punë me nxënës

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Përcjellja e përshtshmërisë së nxënësve të klasës së parë (nëntëvjeçare)	Përshtatja e suksesëshme në mjedis	Në fillim të viti shkollorë , si dhe gjatë vitit	Kujdestarët e klasëve Arsimtarë Prindër Psikolog Pedagog	Individuale Ekipore	Të dhëna për nxënësin Të dhëna për arsimtarin	Lehtësimi në përshtatjen e fëmijëve në mesin e ri
Punë me nxënësit problematik	Të përmirësohet sjellja dhe suksesi I tyre	Gjatë viti shkollorë	Kujdestarë të klasëve Arsimtarët Prindër Psikolog pedagog	Punë individuale Instrumente profesionale Bisedë	Literaturë profesionale	Përcjellja e kontinuar e mësimi
Kyçjë më e shpejtë në Bashkësinë e klasës	Punë me nxënës me vështirësi në socializim	Fillim të viti shkollorë dhe sipas nevojës	Kujdestarë të klasëve Psikolog Pedagog	Këshillim individual	Të dhëna përmes nxënësin	Përcjellja e kontinuar e mësimi
Përmirësimi i sjelljes së nxënësve	Punë me nxënës problem	Gjatë viti shkollorë	Kujdestarë të klasëve Arsimtarë Prindër Psikolog	Instrumente profesionale	Të dhën për prindërit	Përmirësimi I suksesit dhe sjelljes
Kujdes për shëndetin mental të nxënësve	Punë me nxënës me probleme emocionale dhe familjare	Gjatë vitit Sipas nevojës	Arsimtarë Nxënës Prindër Psikolog	Punë individuale	Probleme konkrete	Zgjedhje të problemve
Mbrojtje të shëndetit fizik dhe mental	Pjesëmarje në punë e kujdestarit të klasës, tema nga shëndeti fizik dhe mental	Gjatë viti shkollorë	Kujdestarë klasë Prindër Psikolog	Koordinim. Punë instructive	Programë për punë të kujdestarit të klasës dhe	Ngritja e edukimit shëndetësorë të nxënësve

					njohuri nga seminaret	
Zgjedhja e drejtë të shkollimit të mëtejshëm	Orientim professional dhe këshillim	Gjatë vitit	Kujdestarë të klasëve Psikolog	Këshillim individual dhe gruporë	Literaturë profesionale	Miratimi I vendimeve të përshtatshme
Nxitja për sjellje positive	Përpunim të temave me karakter edukativ	Gjatë viti	Nxënës Arsimtar Psikolog Pedagog	Punëtori	Literaturë profesionale	Përmirësimi i disiplinës në shkollë
Kyçja e nxënësve në notim dhe vetënotim	Ndryehime në notim dhe etikshmëria në notim	Tetor Nëntor	Nxnës Kujdestarë klase	Punëtori Bisedë	Literaturë profesionale Ligji Kodeksi Etik	Ritja e motivimit për sukses
Diagnostifikimi I gjendjes së notimit	Si notojnë arsimtarët	Gjatë viti shkollorë	Nxënës Bashkësi e nxënësve	Anketim Bisedë	Raport Procesverbale	Zbatimi I mënyrës së re të përcjelljes dhe Notimit
Verifikimi I klimës sociale në paralele	Përdorimi I metodës Sociometrike në dy paralelet në klasë të V	Shkurt	Nxnës Kujdestarë klase	Anketim Këshillim individual dhe gruporë	Rezultate të fituara nga anketimi	Përmirësimi i klimës sociale në paralele
Realizimi I suksesshëm I aktiviteteve të planifikuara	Ndihmë në realizimin e aktiviteteve të bashkësisë së klasës	Gjatë viti shkollorë	Nxënës Anëtrë të Bashkësisë së klasës	Këshillim Punë instruktive	Programë për punë të Bashkësisë së nxënësve	Ngritja e përgjegjësisë dhe motivimit të nxënësve

7.Klima socio – emocionale positive

Në mësim nuk është me rëndësi vetëm arritja e notave të mira, por edhe nxënia e përvojës që do të ndihmojë për funksionimin e mëtejshëm me sukses të nxënësit në shoqërinë demokratike.Për këtë, realizimi i qëllimeve edukativo-arsimore në shkollë në masë të madhe varet nga klima socio - emocionale që ekziston në shkollë.

Në krijimin e klimës pozitive në shkollën tonë ndikojnë më tepër faktorë, të cilat në mënyrë të ndërsjellë janë të lidhura dhe të ngatërruara.Një pjesë prej tyre janë relativisht objektive dhe më vështirë mund të ndryshohen, si për shembull: madhësia e vendit ku gjendet shkolla, numri i nxënësve në klasë, struktura socio-demokratike e nxënësve, etj.Tjerat janë subjektive dhe në këto mund të ndikohet, e me këtë mund të ndryshohet edhe klima në shkollë dhe klasë.Në mesin e të gjitha këtyre faktorëve,rol kryesor ka mësimdhënësi, me stilin e tij të udhëheqjes, karakteristikat e tij personale dhe me profesionalizmin e tij.

Klima pozitive kontribuon edhe për angazhim më të madh dhe më cilësor të mësimdhënësve gjatë realizimit të qëllimeve të vendosura edukativo-arsimore, arritjes më të mirë në shkollë, qëndrimeve pozitive të nxënësve ndaj mësimdhënësve dhe ndaj shkollës, si dhe ndaj marrëdhënieve të mira ndërpersonale.

Në përgjithësi, duke punuar në krijimin e klimës socio - emocionale në shkollën tonë, jemi të orientuar në qëllimin që njëkohësisht të mbahet kujdesi për nevojat emocionale dhe sociale të nxënësve.Zhvillimi i sjelljes së mirë në klasë nga aftësia e mësimdhënësit t'i plotësojë nevojat sociale dhe emocionale të nxënësve.Një vëmendje e posaçme i kushtohet grupit të prekur e të detektuar të nxënësve në këtë aspekt, me ç'rast mësimdhënësit tanë udhëhiqen sipas parimeve në vijim:

- Mësimdhënësi është i gatshëm t'i dëgjojë nxënësit;
- Mësimdhënësi është i gatshëm t'u përgjigjet sugjerimeve të tyre;
- Mësimdhënësi është i gatshëm t'i pranojë dhe kuptojë ndjenjat e tyre;
- Mësimdhënësi është i gatshëm t'i përfshijë në procesin mësimor dhe t'i inkurajojë gjatë punës.

Këto komponentë që janë pjesë e marrëdhënieve ndërpersonale të cilat ekzistojnë në klasë mundësojnë të ekzistojë liria në komunikim, të marrin pjesë gjatë

miratimit të vendimeve, të stimulojnë udhëheqjen e nxënësit, fleksibilitetin, etj.Në këtë mënyrë, arrijmë të krijojmë një klimë emocionale të mirë, të mbështetur dhe pozitive në klasë.

Shërbimi profesional në shkollë është detyruar për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve në këtë fushë, e këto parashihen në

8. Orientimi profesional i nxënësve

Qëllimi i përgjithshëm i programit është vetëdijësimi i nxënësve që me anë të pjesëmarrjes aktive në procedurën e modelit pesëfazor të orientimit profesional, të marrin përsipër përgjegjësi për të ardhmën e tyre, të njohin vetën dhe aftësitë e veta, rrugët e shkollimit dhe rrugët e karrierës, të njoftojnë botën e punës, që të marrin të menduar mirë vendimin për zgjedhjen e shkollimit/profesionit dhe në këtë mënyrë të arrijnë sukses në planifikimin e karrierës së vet.

Programi i orientimit profesional ka për qëllim ndërtimin e aftësive për vendim-marrje tek të rinjtë .

Shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete specifike për orientimin profesional të nxënësve. Qëllimi i të gjitha aktiviteteve është informimi dhe orientimi i duhur profesional dhe i duhur i nxënësve, nxënësve për tu njohur me mundësitë e ofruara nga shkollat e mesme, strukturat dhe profesionet, për t'u informuar kushtet dhe kriteret për regjistrimin në shkollën e mesme, duke zbuluar interesat dhe dëshirat e nxënësve për të vazhduar të arsimit, ofrimit të ndihmës për zgjedhjen e saktë të profesionit dhe profesionit. Fusha e orientimit profesional të nxënësve është puna e vazhdueshme gjatë arsimit bazë të tyre, ata njihen me profesione, në mënyrë që të inkurajohen të zgjedhin profesionin e ardhshëm.

Bashkëpunëtorët profesional bëjnë biseda me nxënësit për vazhdimin e shkollimit përmes të cilit ata njihen me interesat dhe synimet e nxënësve për vazhdimin e shkollimit. Poashtu bëhen edhe biseda individuale dhe grupe ku zhvillohen me shokët e klasës për interesat e tyre profesionale për zgjedhjen e saktë të profesioneve, marrjen e informacionit për përgatitjen e CV-së, letrën e motivimit dhe planin e zhvillimit të karrierës për nxënësit, etj. aktivitete që lidhen me këshillimin në karrierë të nxënësve. Prezantimet e profesioneve nga shkollat e mesme shtetërore dhe private në qytet organizohen përmes të cilave nxënësit njihen me kushtet dhe kriteret për regjistrimin në arsimin e mesëm.

PROGRAMI PËR ORIENTIMIN PROFESIONAL TË NXËNËSVE

Aktivitetet	Resurset	Bashkëpunëtorët	Koha e realizimi
Anketë me nxënësit	Listat anketuese	Nxënësit-psikolog	Mars

Vizita nga shkollat e mesme dhe prezantimi para nxënësve	materiali propagandues për shkollat e mesme, materiali për prezantim	përfaqësuesit e shkollave të mesme, profesorët, nxënësisherbimi profesional	Mars-Prill
Shqyrtimi i konkursit për regjistrim në shkollën e mesme	konkurs	nxënësit, prindërit, kujdestarët e klasave sherbimi profesional	Prill
Orijentim profesional	teste , analiza , raporti	nxënësit, kujdestarët e klasave sherbimi profesional	Prill- Maj
Prezantimi i rezultateve të marra – intervistë me nxënësit	teste , analiza	nxënësit, prindërit, kujdestarët e klasave sherbimi profesional	Prill- Maj
Bisedë me nxënësit	konkursi për regjistrim në shkollë të mesme, materiali propagandue	Nxënësit sherbimi profesional	Maj

9. Protokoli për reagim në rast të dhunës në shkollë

Shkolla është vend ku nxënësit duhet të ndjehen të sigurtë dhe të mbrojtur. Ajo është një bashkësi, ku nevojitet të mbizotëron dashuria, komunikimi ndërnjerëzor i ngrohtë dhe kujdesi për të gjithë anëtarët. Gjithashtu është vend ku në të njejtën mënyrë ju kushtohet vemendje të arriturave mësimore si dhe zhvillimit emocional të nxënësve.

Sot, dhuna ndërmjet moshatarëve paraqet një problem serioz jo vetëm nëpër shkolla por, edhe mbrenda në familje në mbarë botën. Dhuna ndërmoshatare paraqet një problem kompleks. Fëmijët në shkollë por, edhe jashtë saj, mundet që në vazhdimësi të jenë të atakuar dhe të shqetësuar nga ana e moshatarëve të tyre. Shpesh ky problem minimizohet ose injorohet, ndërsa përgjegjësia çdo herë hudhet të të tjerët. Shumë hulumtime të kryera në mbarë botën tregojnë faktin se, në dhunë janë të ekspozuar një numër i madh i fëmijëve, që sjell deri tek pasojat e dëmshme lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Qëllimet për nxënësit janë:

- Të dijnë/kuptojnëse çka është dhuna dhe cilat forma të saj ekzistojnë;
- Të fitojnë njohuri dhe dituri si dhe të përgadien që në dhunën të reagojnë në mënyrë konstruktive (personat që vëzhgojnë dhunën, ato që përjetojnë dhe personat që janë kryes të dhunës);
- Të mësojnë që të kënaqin nevojat dhe emocionet e tyre, pa cënuar të drejtat e të jerëve,duke shfrytëzuar shkathtësitë adekuate komunikative si dhe të dijnë që të vetëkontrollojnë dhe kontrollojnë ndjenjat e dhunshme;
- Të miratojnë rregulla, të cilat bazohen në vlerat kundër dhunës;
- Të dijnë dhe të kuptojnë më shumë rreth rëndësisë dhe qasjes për punën ekipore në bashkësinë e klasës;

Çka paraqet dhuna ndërmoshatare?

Për dhunën ndërmjet fëmijëve flasim kur një ose më shumë fëmijë në vazhdimësi dhe me qëllim shqetësojnë, sulmojnë ose lëndojnë fëmijë të tjerë, të cilët nuk mund të mbrohen. Dhuna mund të jetë në formë të kërcënimit, lëndimit të lehtë, përjashtimin, përqeshjen, kur mërzhisin tëtjerët, thashethemet, marja e sendeve të huaja e të tjera. Zakonisht, dhuna ndodh nëpër korridoret e shkollave, në oborret e shkollave, gjetë manifestimeve të ndryshme si dhe nëpër ndeshje të ndryshme sportive.

Dhuna ndërmjet fëmijëve, fillimisht mund të ndahet në dy faza, edhe atë: dhunë fizike dhe dhunë verbale.

Dhuna ndërmjet moshatarëve mund të përhapet qysh në fëmijërinë e hershme dhe vazhdon deri në moshën madhore. Nuk ekziston një përgjigje e plotë se: Pse një fëmijë fillon të sillet në mënyrë të dhunshme? Por, ekzistojnë disa veçori tek familjet e tyre, të cilat ndikojnë që fëmija i asaj familjeje të manifeston sjellje të dhunshme.

Akti i dhunës

Arsimtar	Nxënës
➤ Arsimtari, kujdestari i klasës, arsimtari i lëndës ose ndonjë tjetër më i rritur duhet të reagojë menjëherë për t'i dhënë fund dhunës ➤ Ndan nxënësit nëse bëhet fjalë përleshje fizike ➤ Nëse arsimtari vlerëson se ai nuk do të jetë në gjendje ta parandalojë situatën vetë, duhet të kërkon ndihmë nga sigurimi shkollor, policia ose të rrituri tjetri ose bashkëpunëtori profesional, ➤ Telefonon ose siguron ndihmën e parë në rast të lëndimit ➤ Nëse bëhet fjalë për maltretime, kërkohet ndërprerje e ndërmjet palëve të përfshira	Një nxënës i cili është viktimë ose dëshmitar i dhunës është i detyruar të kërkojë ndihmën e kujdestarit të klasës, arsimtarit ose shërbimit profesional.

Sjellja pas aktit të dhunës

Arsimtar	Nxënësi	Prindi	Shërbimi profesionalprofesional	Shkolla
Një arsimtar i cili ka informacione për një incident të dhunës është i detyruar ta informojë drejtorin dhe shërbimin profesiona	Një nxënës i përfshirë në një incident të dhunës është i detyruar ta raportojë atë tek kujdestari i klasës ose shërbimi profesional	Prindi i nxënësit të përfshirë në incidentin e dhunës është i detyruar t'i japë një deklaratë kujdestarit të klasës shërbimit profesional ose drejtorit	- Shërbimi profesional pas raportimit të incidentit të dhunës është i detyruar të hetojë rastin, duke marrë një deklaratë nga të gjitha palët e përfshira dhe subjektet e tjera relevante (bashkësia e klasës, arsimtari i lëndës, prindër, policia, qendrat për punë sociale etj.) - Shërbimi profesional ndërmerr bisedë këshillimore me nxënësit, prindërit dhe nëse është e nevojshme bashkëpunon me institucione të tjera - Shërbimi profesional është i detyruar të informojë drejtorin, këshillin arsimor dhe institucionet e tjera përkatëse për aktivitetet e kryera për të zgjidhur incidentin e dhunës	Shkolla shqipton një masë pedagogjike për nxënësit e përfshirë në një incident të dhunës në varësi të ashpërsisë së veprës së kryer dhe sipas Rregullores për shqiptimin e masave pedagogjike të MASH

10. PROGRAMI PËR KËSHILLIM TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE /KUJDESTARËVE TË NXËNËSVE

Sipas Programit për këshillim të prindërve/kujdestarëve të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 4/12), këshillimi i prindërve ka dy qëllime themelore: (1) njohja e prindërve. e nxënësve që ndjekin rregullisht mësimdhënien, zvogëlojnë suksesin në të mësuar dhe/ose shfaqin një formë të sjelljes së papërshtatshme me natyrën dhe rëndësinë e problemit që ka ndodhur te fëmijët e tyre dhe (2) edukimi i prindërve për mënyrat për të përmirësuar aftësitë e edukimit të fëmijëve dhe për marrëdhëniet familjare janë të përmirësuara në mënyrë që fëmijët e tyre të përballen më me sukses me lloje të ndryshme vështirësish.

Prindërit/kujdestarët e nxënësit thiren në këshillim nëse nxënësi

- Ndjek mësimin në mënyrë të parregullt për arsye të paarsyeshme , përkatësishtë ka m, shumë se 10 mungesa të paarsyeshme
- Ka sukses të pakënaqshëm(tre ose më shumë nota të dobëta në fundë të tre mujorit ose gjashtëmujorit)
- Manifeston forma të ndryshme të sjelljes së papërshtatshme
- Krahas këshillimit të prindërve /kujdestarëve , si pjesë e domosdoshme e mbështetjes ,realizohet edhe këshillim me fëmijët e tyre,përkatësishtë me nxënësit
- Psikologët, gjegjësisht pedagogët realizojnë këshillim me prindërit /kujdestarët nëse takimet e mëparshme të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të paraleleve me prindërit nuk kanë sjellë përmasimin e gjendjes.

PROGRAMI PËR KËSHILLIM TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE /KUJDESTARËVE TË NXËNËSVE

Përmbajtja	Qëllimet	Koha e realizimit	Bashkë Punëtorë	Format e Punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Këshillime në grup me prindër / kujdestar të nxënësve me Problem në të nxënë,të paregullt dhe nxënësit problematik	Përmisimi i gjendjes	Nëntor Prill	Psikolog Kujdestar klase Punë ekipore	Bisedë Këshillim Motivim Formulare	Kujdestar të klasave Raportet	Përmisim i gjendjes aktuale

Këshillime me nxënës me probleme në të nxënë	Përmisimi i gjendjes	Në kontinuitet	Psikolog Kujdestar klase	Anketim Këshillim Bisedë	Raportet Të dhëna për nxënësin	Ritja e motivimit për sukses
Këshillime me nxënës të paregullt	Përmisimi i gjendjes	Gjat vitit	Psikolog Kujdestar klase	Anketim Këshillim	Raportet Të dhënat për nxënësin	Përmisim I disciplines në shkollë
Këshillime me nxënës problematik	Përmisimi i gjendjes	Gjat vitit	Psikolog Kujdestar klase	Anketim Këshillim	Process verbalet	Përcjellja në kontinuitet e mësimi



Punoi:

Psikologu i Shkollës Filllore Komunale “Liria” – Tetovë

ELVIRA SHAQIRI